



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 20 prill 2012
Nr. Ref.: RK220/12

ATKVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI 01/10

Parashtruesi

Gani Ibërdemaj

**Vlerësim i kushtetutshmërisë të Vendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë
Ac. nr. 1224/09, të 12 nëntorit 2009**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, Zëvendës-kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar
Gjyljeta Mushkolaj, gjyqtare dhe
Iliriana Islami, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Gani Ibërdemaj nga Prishtina, të cilin e përfaqëson avokati Feriz Gërvalla po ashtu nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin Ac.nr.1224/09 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të 12 nëntorit 2009 që i është dorëzuar atij më 23 nëntor 2009.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës ankohet se me vendimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës Ac. nr. 1224/09, të 12 nëntorit 2009, i janë shkelur të drejtat për pronë të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e pronës] dhe me nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 47.2 i Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe rregulli 56 (2) i Rregullores së Punës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 6 janar 2010, parashtruesi i kërkesës e parashtrroi kërkesën në Sekretariatit e Gjykatës Kushtetuese. Kërkesa iu komunikua Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 23 mars 2010.
6. Gjykata e Qarkut u përgjigj më 26 mars 2010 duke thënë se dosja e lëndës në rastin e procedurës civile c. nr. 117/2008 ishte kthyer në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
7. Më 11 maj 2010 Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e emëroi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues si dhe kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Gjyljeta Mushkolaj.
8. Më 14 dhjetor 2010 kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe pas këshillimit për këtë çështje i paraqiti rekomandimin Gjykatës në përbërje të plotë.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 15 qershor 2009 Gjykata Komunale në Prishtinë nxori vendimin C. nr 117/2008, me të cilin e miratoi kërkesë padinë e parashtruesit të tanishëm të kërkesës, Gani Ibërdemaj, duke konstatuar që të paditurit, Enver Aliaj dhe Mehmet Alijaj, kanë penguar në pronë parashtruesin e kërkesës dhe i urdhëroi ata që të ndalojnë së penguari tani dhe në të ardhmen si dhe të largojnë të gjitha pengesat e pretenduara.
10. Përfaqësuesi ligjor i të paditurve ushtroi ankesë ndaj këtij vendimi, me propozimin që të prishet vendimi, kërkesë padia e paditësit të refuzohet si e pabazë ose të anulohet, si dhe çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë për rigjykim. Paditësi parashtrroi përgjigje në ankesën e të paditurit me propozimin që ankesa të refuzohet si e pabazë, dhe që vendimi i Gjykatës Komunale të vërtetohet.
11. Më 12 nëntor 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë nxori vendimin Ac. nr. 1224/09 me të cilin vendosi ta anulojë vendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C .Nr 117/2008, të 15 qershorit 2009, dhe ta hedhë poshtë kërkesë padinë e parashtruesit të kërkesës si të papranueshme.

12. Gjykata e Qarkut në Prishtinë konstatoi se Gjykata Komunale ka gabuar sepse çështja në kontest nuk është pengimi në pronë dhe se nuk është në juridiksionin e Gjykatës Komunale.
13. Gjykata e Qarkut në Prishtinë konkludoi që “paditësi në situatën konkrete nuk gëzon mbrojtje gjyqësore për pengim në posedim të pronës së paluajtshme e cila është pjesë e planit urbanistik. Të gjitha çështjet e diskutueshme në raport me të drejtën në pronë mbi pronën e paluajtshme (. . .) do të zgjidhen në procedurë kontestimore në pajtim me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat tjera Sendore”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

14. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimi i Gjykatës së Qarkut është i paligjshëm sepse ai shkel dispozitat e procedurës kontestimore dhe gabimisht konkludon se ky kontest nuk është kontest i posedimit të nënkuptuar dhe nuk është në juridiksionin e Gjykatës Komunale.
15. Parashtruesi i kërkesës argumenton se toka ndërtimore urbane gëzon mbrojtje gjyqësore nga pengimi apo shqetësimi i posedimit të fundit faktik.
16. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës konkludon se me vendimin e lartpërmendur gjyqësor i është shkelur “e drejta themelore e mbrojtjes së pronës e parashikuar me nenin 46 paragrafi 1 dhe 2 dhe neni 54 (mbrojtja gjyqësore e të drejtës për shfrytëzim të pronës) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesja e kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë, dhe të specifikuar më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
18. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës në lidhje me nenin 47.2 të Ligjit i cili parashikon:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

“47.2 Individu mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

19. Parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar se ka ndërmarrë hapa për të zgjidhur kërkesën e tij nëpërmjet procedurës kontestimore në pajtim me Ligjin për Pronën dhe të Drejtat tjera Sendore, siç përshkruhet në aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
20. Gjykata e përdori të njëjtin arsyetim mbi baza të mos-shterjes së mjeteve juridike kur e nxori Aktvendimin për Papranueshmëri, më 27 janar 2010, në rastin Nr. KI41-09, Universiteti AAB-RIINVEST SH.P.K. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës, dhe në vendimin e saj të 23 marsit 2010, në rastin Nr. KI73/09, Mimoza Kusari Lila kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
21. Më herët Gjykata kishte theksuar se arsyetimi mbi kërkesën e shterimit është që t’iu ofrojnë autoriteteve në fjalë, duke përfshirë gjykatat, mundësinë për të parandaluar ose për të korrigjuar shkeljen e supozuar të Kushtetutës. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Kosovës do të sigurojë mjete efektive kundër shkeljes së të drejtave

kushtetuese. (shih *mutatis mutandis*, GJEDNJ, Selmouni kundër Francës, nr. 25 803/94, vendim i datës 28 korrik 1999). Megjithatë, nuk është e domosdoshme që të drejtat kushtetuese të cekën në mënyrë eksplicite gjatë procedurës në fjalë. Deri sa kjo çështje është ngritur në mënyrë implicite ose substanciale, kërkesa mbi shterimin e mjeteve është plotësuar (shihni, *mutatis mutandis*, ECHR, Azinass kundër Qipros, nr. 56679/00, Vendimi i 28 prillit 2004)

- 22 Gjkata rrjedhimisht konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk i ka shterur të gjitha mjetet e disponueshme juridike të parashikuara me ligj.

PËR KËTO ARSYE

Gjkata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit, dhe rregullin 56 (2) të Rregullores së Punës, me shumicë votash

VENDOS

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani